



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË

22.06-2026

Nr. Prot:

Titulli	Numri	Shifra	Vlera
	03	2059	4

Datë: / /

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)

Fakulteti:

Fakulteti i Filologjisë

Pozita e shpallur në thirrje:

III.1

Lëndët:

Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA)
Testimi dhe vlerësimi (BA)
Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA)
Planifimi i orës mësimore (BA)
Mesimdhënia e anglishtes për grupmoshat e reja (BA)

Kandidatët e paraqitur:

Kushtrim Xhaferi
Gentian Jetishi
Besiana Tifeku
Nuhi Bllaca
Diona Berisha
Ardita Ibishi Mehmeti
Enes Ismeti
Xhevdet Rusinovci

Arjana Zhubi
Dhurata Çoçaj
Sarandë Bublaku
Rina Krasniqi

Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Thirrja për angazhim:

Një mësimdhënës për lëndët:
Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA)
Testimi dhe vlerësimi (BA)
Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA)
Planifimi i orës mësimore (BA)
Meismdhënia e anglishtes për grupmoshat e reja (BA)

Komisioni vlerësues:

1. Kryetare
2. Anëtare
3. Anëtare

Prof. asoc. dr. Seniha Krasniqi
Prof. asst.dr. Lendita Kryeziu
Prof. asst.dr. Blertha Mustafa

Nr	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata				Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Mosha (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vite)	Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për	Përvoja e punës profesionale në	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në					
1.	Kushtrim Xhaferi	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	Jo	
2.	Gentian Jetishi	MA	X	Punimi nuk është në Scopus/WoS	X	6,61	7.10	X	39	15	X	Jo	
3.	Besiana Tifeku	MA	X	Punimi nuk është në Scopus/WoS	X	7.65	Nuk ofron	X	36	X	X	Jo	
4.	Nuhi Bllaca	PhD	X	3	X	6.75	8.10	X	43	5	X	Jo	
5.	Diona Berisha	MA	X	Nuk ka punim	X	8.48	8.70	X	25	1	X	Jo	
6.	Ardita Ibishi Mehmeti	MA	X	1	X	8.90	9,15	X	32	8	X	Jo	

7.	Enes Ismeti	Phd	x	2	x	7.35	8.50	x	28	1	x	Jo
8.	Xhevdet Rusinovci	PhD	x	2	X	x	x	x	46	18	x	Jo
9.	Arjana Zhubi	PhD	x	2	X	8.09	8.33	x	53	2	x	Jo
10.	Dhurata Çoçaj	MA	x	x	X	x	x	x	31	x	x	Jo
11.	Sarandë Bublaku	MA	x	Nuk ka punim	X	9,84	9,73	x	32	4	x	Jo
12.	Rina Krasniqi	PhD	x	2	X	8,81	8,37	x	31	3	x	Po

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Ky raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm).

Kandidati **Kushtrim Xhaferi** nuk është përzgjedhur për pozitën pasi aplikacioni i tij nuk ka qenë i kompletuar në përputhje me kërkesat e konkursit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se kandidati ka dorëzuar vetëm Curriculum Vitae (CV), ndërsa nuk ka paraqitur dokumentacionin tjetër të kërkuar për aplikim. Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës, komisioni nuk ka pasur mundësi të verifikojë dhe vlerësojë kualifikimet, përvojën dhe kriteret e tjera të përcaktuara në konkurs.

Për rrjedhojë, aplikacioni nuk është konsideruar i plotë dhe kandidati nuk ka mundur të vazhdojë në fazat e mëtejshme të procesit të vlerësimit.

Kandidati **Gentian Jetishi** ka kryer studimet Bachelor në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze, i njëjti posedon kualifikimin Master në Menaxhim dhe Zhvillim nga Kolegji Universum International College. Megjithatë, nuk posedon gradën shkencore Doktor i Shkencave (PhD), e cila është konsideruar përparësi e rëndësishme gjatë procesit të vlerësimit.

Sa i përket veprimtarisë kërkimore-shkencore, kandidati nuk ka publikime të indeksuara në bazat ndërkombëtare Scopus ose Web of Science (WoS), të cilat përbëjnë një nga treguesit kryesorë të aktivitetit dhe cilësisë akademike. Kandidati ka ndjekur trajnime në fushën e edukimit në karrierë dhe metodologjisë së mësimdhënies, të cilat vlerësohen pozitivisht, por nuk kompensojnë mungesën e kualifikimeve dhe publikimeve shkencore të kërkuara për pozitën.

Gjithashtu, kandidati ka publikuar tre libra, por përmbajtja e tyre nuk lidhet drejtpërdrejt me fushën relevante të pozitës për të cilën ka aplikuar, prandaj nuk janë vlerësuar si kontribut i drejtpërdrejtë në përmbushjen e kërkesave të pozitës.

Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të dokumentacionit dhe krahasimin me kandidatët e tjerë, është konstatuar se kandidati nuk ka arritur nivelin e kërkuar të kualifikimeve akademike dhe shkencore për t'u përzgjedhur për këtë pozitë.

Kandidatja **Besiana Tifeku** ka përfunduar studimet Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Universitetin e Prishtinës. Ajo ka përfunduar gjithashtu studimet Master of Arts in TESOL në University of Westminster, London (2024), mirëpo nuk ka paraqitur

dëshmi për njohjen (nostrifikimin) e kësaj diplome. Nga ana tjetër, kandidatja posedon gradën Master i Shkencave në Mësuesi të Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë nga Universiteti i Tiranës (2018), për të cilën ka paraqitur vendimin për nostrifikim.

Në dokumentacionin e dorëzuar, kandidatja përmend edhe kualifikimin CELTA (Certificate in English Language Teaching to Adults), por nuk ka ofruar dëshmi që vërtetojnë përfundimin e këtij programi.

Sa i përket veprimtarisë shkencore, kandidatja ka paraqitur një punim të publikuar në revistën “Research and Scholarship Quarterly” (2025). Megjithatë, kjo revistë nuk është e indeksuar në bazat e të dhënave Scopus ose Web of Science, të cilat merren parasysh nga Universiteti i Prishtinës për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe akademike.

Edhe pse në CV-në e saj kandidatja deklaron përvojë pune që nga viti 2016 në institucione të arsimit të mesëm në Kosovë dhe, nga viti 2024, në kolegje në Mbretërinë e Bashkuar, ajo nuk ka paraqitur dëshmi përkatëse që do të mundësonin verifikimin dhe vlerësimin e kësaj përvoje profesionale.

Për më tepër, kandidatja nuk posedon gradën shkencore Doktor i Shkencave (PhD), e cila përbën një përparësi të rëndësishme për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata. Gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se kandidatë të tjerë të kualifikuar për këtë pozitë posedojnë gradën e doktoratës dhe, rrjedhimisht, kanë përparësi akademike dhe shkencore në raport me kandidaten.

Kandidati **Nuhi Bilaca** ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Departament të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Universitetin e Prishtinës, ndërsa doktoraturën në Studime Angleze dhe Amerikane (English and American Studies) e ka përfunduar në Universitetin e Vjenës, me fokus në mësimin e shkrimit bashkëpunues në mësimin e anglishtes si gjuhë e huaj.

Në aspektin e zhvillimit profesional, ai ka ndjekur certifikime dhe trajnime ndërkombëtare, përfshirë TESOL nga Arizona State University, si dhe programe për transformim digjital dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe vlerësim, duke dëshmuar angazhim në zhvillimin e vazhdueshëm pedagogjik.

Në mësimdhënie në arsimin e lartë, kandidati ka përvojë si ligjërues i jashtëm në Universitetin e Vjenës dhe si profesor i angazhuar në Universitetin e Prizrenit. Ai ka gjithashtu tri publikime të indeksuara në Scopus, që dëshmojnë aktivitet kërkimor në fushën përkatëse.

Megjithatë, pavarësisht profilit akademik dhe përvojës në arsimin e lartë, vërehet se pozita e shpallur kërkon një profil më të theksuar në didaktikë dhe në aspektet pedagogjike të mësimdhënies së gjuhës angleze, me fokus të drejtpërdrejtë në konceptet si hyrje në mësimdhënie dhe të nxënë, mësimdhënia e gjuhës angleze për nxënësit e moshave të hershme etj, dhe këto fusha kërkojnë një

specializim dhe përqendrim më të thelluar studimor dhe profesional në didaktikën e gjuhës angleze, i cili nuk del në mënyrë të mjaftueshme i reflektuar në profilin e kandidatit për këtë pozitë.

Kandidatja **Diona Berisha** ka përfunduar studimet Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, si dhe studimet Master në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, programi Letërsi. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja posedon një vit përvojë pune në fushën përkatëse. Megjithatë, kandidatja nuk posedon gradën shkencore Doktor i Shkencave (PhD), e cila përbën një përparësi të rëndësishme për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata. Në procesin e vlerësimit është konstatuar se kandidatë të tjerë të kualifikuar për këtë pozitë posedojnë gradën e doktoratës dhe, rrjedhimisht, kanë përparësi akademike në raport me kandidaten. Gjithashtu, kandidatja nuk ka publikime në revista shkencore, kriter ky i paraparë në nenin 7, paragrafi 2, pika 2.2 e Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës. Mungesa e këtij kriteri e bën kandidaten të mos i plotësojë kushtet e nevojshme për angazhim në pozitën e shpallur. Bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkurs dhe rregulloret përkatëse, kandidatja nuk është përzgjedhur për këtë pozitë.

Kandidatja **Ardita Ibishi Mehmeti** posedon kualifikim në nivelin Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze nga Universiteti i Prishtinës, si dhe kualifikim në nivelin Master në fushën e Letërsisë. Ajo ka përvojë të konsiderueshme në arsimin e lartë. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtorë e jashtëm për tri vite në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës. Gjithashtu, në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë ka ushtruar detyrën e lektorese së Gjuhës Angleze për tri vite si bashkëpunëtorë e jashtëm, si dhe ka qenë asistente e ushtrimeve për katër vite në të njëjtën lëndë.

Kandidatja ka paraqitur dëshmi për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe trajnime profesionale, si dhe ka një publikim shkencor të indeksuar në Scopus. Megjithatë, dy punimet e tjera të paraqitura nuk janë të publikuara në platforma të njohura dhe të indeksuara që merren parasysh sipas kriterëve të Universitetit të Prishtinës për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe akademike.

Pavarësisht përvojës së saj në arsimin e lartë dhe angazhimit profesional, kandidatja nuk posedon gradën shkencore të doktoratës. Gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se kandidatët e tjerë të kualifikuar për këtë pozitë posedojnë gradën e doktoratës dhe, në përputhje me kriteret e shpallura në konkurs, kanë përparësi akademike dhe shkencore në raport me kandidaten.

Kandidati **Enes Ismeti** ka përfunduar studimet Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", duke ndërtuar bazën e tij akademike në fushën e gjuhës angleze. Më pas, ai ka përfunduar Master në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze në Universitetin e Evropës Juglindore (SEEU) në Tetovë dhe Master në Gjuhësi Angleze në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", duke thelluar përgatitjen e tij në fushën e gjuhës angleze dhe gjuhësisë. Ai ka përfunduar edhe studimet e doktoratës në Gjuhësi Angleze në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Në aspektin kërkimor, ai është autor i dy publikimeve të indeksuara në platformën Scopus, si dhe të dy punime të sapopublikuar që ende nuk shfaqen në këtë platformë, dhe ka marrë pjesë në aktivitete shkencore në fushën e gjuhës angleze.

Sa i përket përvojës në mësimdhënie në arsimin e lartë, kandidati ka një vit përvojë si asistent në Universitetin e Prizrenit, ku ka ofruar mbështetje në lëndët Gjuha Angleze për Biznes 2 dhe Gjuha Angleze për Biznes 3, kryesisht në aspektet e komunikimit në gjuhën angleze dhe detyrave të studentëve.

Megjithatë, përvoja e përgjithshme në mësimdhënie në arsimin e lartë është e kufizuar në kohë dhe nuk shoqërohet me dëshmi të mjaftueshme të trajnimeve të strukturuar në pedagogji dhe didaktikë të mësimdhënies së gjuhës angleze. Po ashtu, mungojnë dëshmi të mjaftueshme të trajnimeve të vazhdueshme në fushën e pedagogjisë dhe mësimdhënies universitare.

Në këtë kuptim, ndonëse kandidati ka përgatitje akademike në fushën e gjuhës angleze dhe publikime shkencore, profili i tij nuk reflekton një përvojë të konsoliduar dhe të vazhdueshme në pedagogji universitare dhe didaktikë të mësimdhënies së gjuhës angleze, e cila kërkohet për këtë pozitë.

Kandidati **Xhevdet Rusinovci** ka përfunduar studimet Bachelor në Universitetin e Prishtinës në programin Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe studimet pasuniversitare në Universitetin e Grazit. Gjithashtu, ai ka përvojë të konsiderueshme në arsimin e lartë, duke qenë i angazhuar që nga viti 2005 në institucione të ndryshme të arsimit të lartë, përfshirë Kolegjin Universum, Kolegjin AAB, Kolegjin Fama dhe Universitetin e Prishtinës deri në vitin 2022. Kandidati ka edhe dy publikime të indeksuara në Scopus si dhe dy libra të botuar.

Megjithatë, gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar nuk është i plotë, pasi kandidati nuk ka bashkëngjitur diplomat e nivelit Bachelor dhe Master, të cilat kërkohen sipas konkursit. Për pasojë, Komisioni nuk ka pasur

mundësi të verifikojë dhe të evidentojë notën mesatare të studimeve, si dhe të plotësojë tabelën e vlerësimit sipas kritereve të përcaktuara në konkurs.

Po ashtu, ndonëse kandidati ka përvojë në arsimin e lartë, ai nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me lëndët e zhvilluara dhe përputhshmërinë e tyre me fushën dhe lëndët e kërkuara në konkurs.

Kandidatja **Arjana Zhubi** ka përfunduar studimet Bachelor në Programin Fillor në Fakultetin e Edukimit, Qendra në Gjakovë, studimet Master në Departamentin e Pedagogjisë, si dhe studimet e doktoratës në fushën e Edukimit. Ajo ka paraqitur dëshmi për dy publikime shkencore të indeksuara në platformën Scopus.

Kandidatja gjithashtu dëshmon pjesëmarrje në një numër të konsiderueshëm trajnimesh profesionale, me fokus në menaxhimin, udhëheqjen dhe qeverisjen në arsim, si dhe në metodologjinë e mësimdhënies në arsimin fillor. Përvoja e saj profesionale përfshin angazhime të gjata në sektorin e arsimit, përfshirë edhe pozita udhëheqëse, si zëvendës drejtoreshë e institucionit arsimor. Ndërsa, në arsimin e lartë, kandidatja ka përvojë dyvjeçare përmes angazhimit të saj në Fakultetin e Edukimit.

Megjithatë, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe kriteret e përcaktuara në konkurs, fusha e kualifikimit akademik dhe e veprimtarisë profesionale të kandidatës është e orientuar kryesisht në edukim, pedagogji dhe menaxhim në arsim. Si rrjedhojë, kjo fushë nuk përputhet me lëndët dhe profilin akademik të kërkuar në konkurs.

Për këtë arsye, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, pika 2.1 të rregullores përkatëse, kandidatja nuk i plotëson kriteret lidhur me përputhshmërinë e fushës së studimit me lëndët e shpallura në konkurs dhe, rrjedhimisht, nuk është përzgjedhur për këtë pozitë.

Kandidatja **Dhurata Çocaj** nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të përcaktuara në thirrjen me nr. prot. 1/746, të datës 29.05.2026. Për këtë arsye, komisioni nuk ka pasur mundësi të verifikojë dhe vlerësojë në mënyrë të plotë kualifikimet dhe përvojën e saj profesionale.

Sipas të dhënave të paraqitura në CV-në e kandidatës, pa dëshmi mbështetëse përkatëse, ajo ka përfunduar studimet Bachelor në programin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, si dhe studimet Master në Fakultetin e Edukimit, në programin Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Bazuar në informacionin e paraqitur, profili akademik i kandidatës nuk i përket fushës adekuate të kërkuar për pozitën e shpallur. Për më tepër, mungesa e dokumentacionit mbështetës e pamundëson verifikimin e kualifikimeve të deklaruara dhe vlerësimin e përmbushjes së kritereve të konkursit.

Kandidatja **Saranda Bublaku** ka përfunduar studimet Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, si dhe studimet Master në Fakultetin e Edukimit, në programin Mësimdhënia dhe Kurrikula, të cilat janë zhvilluar në gjuhën shqipe, ndërsa pozitën janë në degën e

gjuhës dhe letërsisë angleze. Aktualisht, kandidatja është duke ndjekur studimet e doktoratës në Universitetin e Ljublanës, të regjistruara në vitin 2023.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja ka përvojë pune në Universitetin “Ukshin Hoti” që nga viti 2022. Gjithashtu, ajo ka dëshmuar pjesëmarrje në një numër të konsiderueshëm trajnimesh në fushën e pedagogjisë, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe samite ndërkombëtare.

Megjithatë, kandidatja nuk ka paraqitur publikime në revista shkencore ndërkombëtare, kriter i paraparë si kusht për angazhim sipas nenit 7, paragrafit 2, pika 2.2 e Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës.

Për më tepër, megjithëse kandidatja demonstroi angazhim të vazhdueshëm në zhvillimin e saj profesional dhe akademik, profili i saj akademik është i orientuar kryesisht drejt fushës së mësimdhënies dhe pedagogjisë. Si rrjedhojë, formimi dhe aktiviteti i saj akademik nuk përputhen në masën e nevojshme me fushën specifike të pozitës së shpallur.

Kandidatja **Rina Krasniqi** ka përfunduar studimet Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Universitetin e Prishtinës, si dhe studimet Master në mësimdhënien e gjuhës angleze për folësit e gjuhëve të tjera (TESOL) në Universitetin e Sheffield-it. Gjithashtu, ajo ka përfunduar studimet e doktoratës në SEEU, ku ka hulumtuar mësimdhënien online dhe atë me prani fizike në arsimin e lartë publik në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19. Ajo ka përvojë tre vjeçare në mësimdhënie në arsimin e lartë, nga të cilat dy vite në Departament të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze dhe një në Fakultetin e Arkitekturës.

Kandidatja ka dy publikime të indeksuara në Scopus, të cilat dëshmojnë angazhimin e saj në kërkimin shkencor në fushën e arsimit. Ajo ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm konferencash shkencore dhe profesionale, si pjesëmarrëse dhe prezantuese, duke dëshmuar angazhimin e saj të vazhdueshëm në zhvillimin profesional. Po ashtu, ka ndjekur një sërë trajnimesh dhe programesh zhvillimore, ndër të cilat veçohen programi njëqindorësh për trajnimin e trajnerëve i organizuar në bashkëpunim me KETNET-it dhe Ambasadën Amerikane, i cili është fokusuar në metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës angleze dhe në zhvillimet më të fundit në didaktikën e gjuhës angleze.

Ajo gjithashtu ka ndjekur edhe trajnime të tjera si ai për mësimdhënien e shkrimit akademik i ofruar nga Universiteti Shtetëror i Iowas, trajnimin e specializuar për mësimdhënien e gjuhës angleze për grup moshat e reja, i cili është veçanërisht relevant për lëndën ‘Mësimi i gjuhës angleze për grup moshat e reja’, webinarë të ndryshme përfshirë atë rreth vlerësimit online etj.

Ajo është zgjedhur Presidente e Shoqatës së mësimitdhënësve të Kosovës (Kosovo English Teachers' Network-KETNET), një pozitë që dëshmon vlerësimin profesional që gëzon në komunitetin e mësimitdhënësve të gjuhës angleze për kontributin dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm në këtë fushë.

Kontributi i saj vullnetar në Departamentin e Gjuhës Angleze dëshmon angazhim të jashtëzakonshëm në mbështetje të objektivave të departamentit dhe është dokumentuar edhe përmes mirënjohjeve për ekselencë të dorëzuara si dëshmi e këtij kontributi.

Fokusi i qëndrueshëm në metodologjinë e mësimitdhënies, i dëshmuar në studimet Master në TESOL dhe në doktoratë, i kombinuar me trajnime të specializuara relevante për lëndët përkatëse, njohje profesionale në komunitetin e mësimitdhënësve të gjuhës angleze dhe angazhim të vazhdueshëm në zhvillimin profesional, dëshmon kompetencë të plotë për realizimin me sukses të lëndëve të sipërpërmendura dhe e bën kandidaten zgjedhjen më të përshtatshme për këtë pozitë.

Komisioni vlerësues:

Prof. asoc. dr. Seniha Krasniqi




1.Kryetare

2.Anëtare

3.Anëtare

Prof. asst.dr. Lendita Kryeziu



Prof. asst.dr. Blerta Mustafa

